



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 577 / 1 prot.

Gjirokastrë, më 30.07.2026

Lënda: Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut.

KËSHILLIT TË BASHKISË PËRMET

Përmet

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit të ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut, ju konfirmojmë si më poshtë:

1. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 75, datë 21.7.2026, "Për miratimin e tavaneve përfundimtare të buxhetit afatmesëm 2027-2029", konfirmohet.

2. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 76, datë 21.7.2026, "Për miratimin e përdorimit të fondit rezervë për dhënie ndihme financiare", në bazë të nenit 3, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, 'Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë' nuk është akt me karakter normativ, por akt me karakter individual. Akt normativ nënligjor është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Gjithashtu, neni 4, pika 1, të ligjit nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, përcakton se aktet me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore."

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

3. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 77, datë 21.7.2026, "Për miratimin e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë, muaji korrik 2026", në bazë të nenit 3, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, 'Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë' nuk është

akt me karakter normativ, por akt me karakter individual. Akt normativ nënligjor është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Gjithashtu, neni 4, pika 1, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, përcakton se aktet me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njehershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.”.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

4. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 78, datë 21.7.2026, “Për miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%”, në bazë të nenit 3, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, ‘Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë’ nuk është akt me karakter normativ, por akt me karakter individual. Akt normativ nënligjor është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Gjithashtu, neni 4, pika 1, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, përcakton se aktet me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njehershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.”.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,


PREFEKTI
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Albana Hasana
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTER